



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË

Lënda: Njoftim për shtyrje afati

Drejtuar: Agjencise se Prokurimit Publik

Sot më datë 15.11.2016, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të nenit 42 pika 2/1 si dhe nenit 63 pika 1.1 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X , Neni 78 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe nenit 78 pika 6 gërma ”d” të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” procedura **Kërkesë për propozim** me objekt: **“Blerje pajisje/aksesorë spitalorë për përdorim mjekësorë dhe për shërbimin ndaj pacientit“** me fond limit **5,945,690.70** (pese milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë pike shtate) **lekë pa TVSH**, financuar nga zëri i investimeve i të ardhurave dytësore, është pezulluar si rezultat i paraqitjes së ankesave për Dokumentat Standarte të Tenderit.

Me marrjen e ankesave me shkrim, Autoriteti Kontraktor, “Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, ka ndjekur të gjitha afatet ligjore në lidhje me ankimimet pranë Autoritetit Kontraktor si dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Me date 14.11.2016 ka mbaruar afati 10 ditor për ankimim të mundshëm në Komisionin e Prokurimit Publik, në mbështetje të Nenit 63 pika 4 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 pika 6 gërma ”d” si dhe nenit 62 te VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,Njësia e Prokurimit vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 22.11.2016 , Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 22.11.2016, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al